



III.EF.nr.7/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, duke vendosur lidhur me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit të propozuesit-debitorit “Inter-Eminex”sh.p.k., me seli në Prishtinë zona industrial me NRB 80015232, kundër kundërpropozuesit-kreditorit 1.NLB-Banka me seli në Prishtinë,2.BKT Bank me seli në Prishtinë ,3.Mehmet Limani nga Prishtina rr.”Lidhja e Prizrenit” nr.185 si dhe 4.Izet Limani nga Prishtina rr.”Lidhja e Prizrenit”nr.183, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datë 17.01.2022, merr këtë:

Njoftim: Për shpalljen Publike të Hapjes së Procedurës së Falimentimit

Propozuesit-debitorit “Inter-Eminex”sh.p.k ,me seli në Prishtinë zona industrial me NRB 80015232, panë kësaj gjykate me datë 14.12.2021, ka paraqitur kërkesë për falimentim.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin III.EF.nr.7/21 të datës 14.12.2021 ka vendosur për fillimin e procedurës së falimentimit për: “Inter-Eminex”sh.p.k ,me seli në Prishtinë zona industrial me NRB 80015232, me pronar-drejtor menaxhues Shefqet Ademi, me vendbanim në Prishtinë.

Njoftohen të gjithë kreditorët e mundshëm që kërkesat e tyre ti parashtrojnë pranë Administratorit falimentues të caktuar nga gjykata, Z.Virtyt Ibrahimaga, Rr “Anton Çeta” 5A, Prishtinë, brenda afatit prej 60 ditësh nga data e publikimit të shpalljes. Kërkesat e parashturuara me vonesë nuk do të merren për bazë.

Kreditorët kërkesat e tyre mund ti parashtrojnë në: Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, Pallati i Drejtësisë, Objekti A, Hajvali-Prishtinë

